



RREGULLORE
për masat dhe kriteret për shpërndarjen e mjeteve
për shkollat fillore shtetërore

Shkup, 2025

Në bazë të nenit 55 paragrafit 1 të Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Organeve të Administratës Shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/19, 110/19 dhe 121/24) dhe nenit 160 paragrafit 2 të Ligjit për Arsimin Fillor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 161/19, 229/20, 3/25, 74/25 dhe 250/25), ministrja e Arsimit dhe Shkencës solli

RREGULLORE

për masat dhe kriteret për shpërndarjen e mjeteve për shkollat fillore shtetërore

Neni 1

Me këtë akt përcaktohen standardet dhe kriteret për shpërndarjen e mjeteve financiare për shkollat fillore shtetërore, për zërat dhe nënzërat e kategorive buxhetore 42 – mallra dhe shërbime, 46 – subvencione dhe transfere dhe 48 – shpenzime kapitale.

Përlllogaritjet për shpërndarjen e mjeteve financiare kryhen në bazë të treguesve për shkollat fillore shtetërore dhe në përputhje me mjetet e disponueshme të përcaktuara në Buxhet.

Mjetet financiare për shkollat fillore shtetërore shpërndahen përmes planeve financiare, në përputhje me dispozitat ligjore dhe mjetet e përgjithshme të përcaktuara për këtë qëllim me Buxhetin dhe Ligjin për Realizimin e Buxhetit për vitin fiskal.

Neni 2

Mjetet nga zëri 420 - Shpenzimet e rrugës dhe ditore ndahen me plan financiar, në përputhje me dispozitat ligjore dhe mjetet totale për këtë qëllim të përcaktuara nga Buxheti dhe Ligji për Realizimin e Buxhetit për vitin fiskal.

Neni 3

Mjetet nga zëri 421 – shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport shpërndahen përmes planit financiar, në përputhje me dispozitat ligjore dhe mjetet e përgjithshme të përcaktuara për këtë qëllim me Buxhetin dhe Ligjin për Realizimin e Buxhetit për vitin fiskal.

a) Mjetet për energjinë elektrike, ujin dhe kanalizimin, si dhe për mbledhjen e mbeturinave, shpërndahen si vijon:

1) Për shkollat fillore shtetërore SHFQB "Dr. Zllatan Sremec" - Shkup (100%), SHFQB "IDNINA" - Shkup (100%), SHFQB "Shën Kliment Ohridski" - Novo Sellë (100%), SHFQB "Maca Ovçarova" - Veles (100%), SHFQB "Koço Racin" - Manastir (100%), Shkolla Fillore Shtetërore për të Rritur dhe Fëmijë në Institucione Edukuese-Korrektuese "Anton Semjonoviç Makarenko" – Shkup (100%), në vlerë prej 100% të shumës së faturave.

2. Për paralelet në të cilat realizohet arsimi fillor i muzikës në QShShMB "Ilija Nikollovski Luj"-Shkup (50%), QShShM "Sergej Mihajlllov"-Shtip (50%), QShM "Todor Skalovski Tetoec"-Tetovë (50%) dhe Shkolla Shtetërore e Muzikës - Manastir (100%) të shumës së faturave.

3. Shkolla Shtetërore për Rehabilitimin e Fëmijëve dhe të Rinjve me Shikim të dëmtuar "Dimitar Vllahov" - Shkup (50%).

b) Mjetet për PTT dhe shpenzime të tjera të komunikimit shpërndahen sipas numrit të paraleleve/grupeve edukative, si vijon:

deri në 10 paralele deri në 96.000 denarë në vit
nga 11 deri në 20 paralele deri në 120.000 denarë në vit
21 paralele e më shumë deri në 144.000 denarë në vit

Për shkollat në të cilat realizohet arsimi fillor muzikor në QShShMB "Ilija Nikollovski Luj"-Shkup, QShShM "Sergej Mihajlov"-Shtip QShM "Todor Skalovski Tetoec"-Tetovë dhe Shkolla Shtetërore e Muzikës – Manastir shpërndahet deri në 48.000 denarë në vit.

c) Mjetet për ngrohje me EL-1 (vaj ekstra i lehtë për ngrohje) shpërndahen sipas sipërfaqes që ngrohet, numrit të turneve dhe çmimit të përcaktuar nga Komisioni Rregullator për Energjetikë, të publikuar në periudhën kur hartohet plani financiar për shpërndarjen e mjeteve.

1) Ndrohje vetanake me karburant të lëngshëm:

Numri i turneve	Sasia në litra për 1 m ² të sipërfaqes që ngrohet	
	Norma bazë	Normativ për kushte ekstreme
një turn e gjysmë	10	12
dy turne e gjysmë	12	14
tre turne	14	15
konvikt i nxënësve në përbërje të shkollës	16	16

Me aktvendim të veçantë të ministrit të Arsimit dhe Shkencës përcaktohet për cilat shkolla dhe kur zbatohet norma për ngrohje në kushte ekstreme.

2) Ndrohje qendrore dhe lloje të tjera të ngrohjes:

- për shkollat fillore me qendra burimore që përdorin ngrohje qendrore dhe Shkollën Fillore Shtetërore për të Rritur dhe Fëmijë në Institucionet Edukuese- Korrektuese "Anton Semjonoviç Makarenko" - Shkup (100%) të shumës së faturave;
- për shkollat Shtetërore për Rehabilitimin e Fëmijëve dhe të Rinjve me Shikim të Dëmtuar "Dimitar Vllahov" – Shkup dhe QShShMB "Ilija Nikollovski Luj"-Shkup (50%) nga shuma e faturave.

ç) Mjetet për nënzërat e tjera shpërndahen përmes planit financiar, në përputhje me dispozitat ligjore dhe mjetet e përgjithshme të përcaktuara për këtë qëllim me Buxhetin dhe Ligjin për Realizimin e Buxhetit për vitin fiskal.

Neni 4

Mjetet nga pika 423 - materiale dhe inventar i imët ndahen me plan financiar sipas numrit të paraleleve/grupeve arsimore, edhe atë:

deri në 10 paralelederi në 192,000 denarë në vit
nga 11-20 paralele..... deri në 312,000 denarë në vit
nga 21 paralele dhe më shumë..... deri në 384,000 denarë në vit

Për shkollat në të cilat realizohet arsimi fillor muzikor në QShShMB "Ilija Nikollovski Luj"-Shkup, QShShM "Sergej Mihajlllov"-Shtip QShM "Todor Skalovski Tetoec"-Tetovë dhe Shkolla Shtetërore e Muzikës – Manastir shpërndahet deri 120.000 denarë në vit.

Neni 5

Mjetet nga zëri 424 – riparime dhe mirëmbajtje të vazhdueshme shpërndahen përmes planit financiar, në përputhje me dispozitat ligjore dhe mjetet e përgjithshme të përcaktuara për këtë qëllim me Buxhetin dhe Ligjin për Realizimin e Buxhetit për vitin fiskal.

Neni 6

Mjetet nga zëri 425 – shërbime kontraktuale shpërndahen përmes planit financiar, në përputhje me dispozitat ligjore dhe mjetet e përgjithshme të përcaktuara për këtë qëllim me Buxhetin dhe Ligjin për Realizimin e Buxhetit për vitin fiskal.

Neni 7

Mjetet nga zëri 426 – shpenzime të tjera të vazhdueshme shpërndahen përmes planit financiar, në përputhje me dispozitat ligjore dhe mjetet e përgjithshme të përcaktuara për këtë qëllim me Buxhetin dhe Ligjin për Realizimin e Buxhetit për vitin fiskal.

Neni 8

Mjetet nga zëri 464 – transfere të ndryshme shpërndahen përmes planit financiar, në përputhje me dispozitat ligjore dhe mjetet e përgjithshme të përcaktuara për këtë qëllim me Buxhetin dhe Ligjin për Realizimin e Buxhetit për vitin fiskal.

Mjetet për shujta të ndërmjetme, qëndrim të zgjatur dhe akomodim në konvikt të nxënësve, internat për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore shpërndahen në përputhje me aktvendimin e veçantë të ministrit të Arsimit dhe Shkencës për shumën e pjesëmarrjes për shujta të ndërmjetme, qëndrim të zgjatur dhe akomodim në konvikt të nxënësve, internat, si dhe sipas numrit të përfituesve.

Për shkollat fillore komunale nga komuna e Pllasnicës (përderisa komuna ndodhet në fazën e parë të decentralizimit) shpërndahen mjete sipas planit financiar, dhe atë: për kompensime për pensionim, shpërblime jubilarë dhe ndihmë financiare, në përputhje me rregulloret ligjore dhe fondet totale për këtë qëllim të përcaktuara me Buxhetin dhe Ligjin për Realizimin e Buxhetit për vitin fiskal.

Neni 9

Mjetet nga zëri 480-Blerja e pajisjeve dhe makinerive, 482-Objektet e tjera të ndërtimit dhe 483-Blerja e mobiljeve, shpërndahen me plan financiar, në përputhje me rregulloret ligjore dhe mjetet totale për këtë qëllim të përcaktuara nga Buxheti dhe Ligji për Realizimin e Buxhetit për vitin fiskal.

Mjetet nga zëri 486 - blerja e automjeteve miratohen me aktvendim të veçantë të ministrit të Arsimit dhe Shkencës, mbi bazën e kërkesës të dorëzuar nga shkolla me arsyetim të nevojës dhe vlerësimit të vlerës së prokurimit të automjetit.

Neni 10

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, varësisht mjeteve të miratuara në Buxhetin për vitin aktual për Programin 2, Nënprogramin 20, llogaria e shpenzimeve buxhetore për zërat dhe nënzërat nga kategoritë buxhetore 42 – mallra dhe shërbime, 46 – subvencione dhe transfere dhe 48 – shpenzime kapitale, mund të kryejë ndryshime në planet financiare të mjeteve të shpërndara për shkollat fillore shtetërore.

Neni 11

Shkollat fillore shtetërore obligohen t'i përdorin mjetet në mënyrë të qëllimshme dhe racionale, në përputhje me dispozitat ligjore, aktet nënligjore, aktet e brendshme dhe standardet më të larta të sjelljes etike.

Neni 12

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje pushon së vlefshmi Rregullorja për masat dhe kriteret për shpërndarjen e mjeteve për shpenzime materiale për shkollat fillore shtetërore nr. 12-15837/1, të datës 30.12.2022.

Neni 13

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj dhe do të zbatohet nga data 01.01.2026.

**Министерка за образование и наука,
Ministre e Arsimit dhe Shkencës,
проф. д-р Весна Јаневска**

Nr.12-15999/1
19.12.2025
Shkup